

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.113/2015 “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Zhvillim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm,
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Nuk ka përafrim me legjislacionin e BE-së
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Nuk ka
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	23.06.2022
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	22.06.2022
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Jo
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2022–MBZHR- Nr.3
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Entela Kola e-mail-i: entela.kola@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0688535551 Glaudiana Musaj e-maili:glaudiana.musaj@bujqesia.gov.al numri i telefonit: 0688846379
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë?</i> Gjatë periudhës 6 vjeçare të funksionimit të Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar (në vijim Urdhri), si një ent publik jobuxhetor, profesional, i pavarur dhe pjesë e strukturave veterinarë, nëpërmejt zbatimit të Programit të Edukimit në Vazhdimësi janë kryer një sërë trajnimesh, të cilat kanë pasur efekte pozitive në rritjen e standardeve në veprimtarinë profesionale të mjekëve dhe teknikëve veterinarë, duke garantuar kështu cilësi më të larta shërbimi për mirëqenien dhe mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjen e shëndetit publik veterinar. Por gjatë përmbushjes së misionit të tij janë shfaqur edhe disa probleme ligjore, të cilat kanë penguar dhe vështirësuar mirëfunksionimin e Urdhrit, ku ndër më kryesoret janë: pamundësia financiare për përmbushjen e të gjitha detyrimeve ligjore për shkak të anëtarësisë së kufizuar, përfaqësimi më të lartë i të zgjedhurve në Këshillin Kombëtar të Urdhrit në raport me numrin e anëtarësisë, duke rritur koston për këtë Urdhër. Ndërkohë pa qëndrueshmëria e strukturave të Urdhrit për shkak të periudhës 3 vjeçare të mandatit të tyre, si dhe disa mungësa në ligj siç janë: të drejta dhe detyrat për anëtarët e urdhrit, kanë çuar në uljen e efektivitetit të punës së urdhrit veterinar në lidhje me përmbushjen e misionit ligjor të tij. Referuar përvojës 6 vjeçare, përmbushja me sukses e misionit të Urdhrit, që është “<i>Ruajtja e standardeve të larta në formimin, sjelljen profesionale dhe ushtrimin e profesionit të mjekut veterinar, duke garantuar mbrojtjen e shëndetit, mirëqenies së kafshëve dhe mbrojtjen e shëndetit publik</i>”, kërkon një fond vjetor prej rreth 10 milion, ose rreth 5 milion më shumë se të ardhurat	

faktike vjetore që realizon Urdhri.

Ekzistenca e këtij fondi vjetor do të shërbejë për kryerjen e disa aktiviteteve dhe veprimtarive profesionale shtesë dhe shumë të nevojshme, të cilat nuk janë realizuar deri tani për shkak të pamundësive financiare, si dhe do ta vendosë Urdhrin në kushte barazie me urdhrat e tjerë (Urdhrin e Mjekut Human, Urdhrin e Stomatologut, Urdhrin e Infermierit e të tjerë, që janë mbështetur me financim më shumë se një vit).

Aktivitete shtesë dhe shumë të domosdoshme për rritjen e performacës së urdhrit janë:

- ✓ Vendosja e një juristi pranë urdhrit si dhe krijimi i rrjetit të koordinatorëve mbi bazë qarku, i nevojshëm ky për evidentimin, regjistrimin dhe futjen në skemën e edukimit, certifikimit dhe të financimit të të gjithë mjekëve veterinarë zyrtarë apo privatë, që nga rreth 1250 vetë të evidentuar gjithsej në nivel kombëtar, janë të formalizuar deri tani rreth 700 vetë;
- ✓ Ngritja e Portalit të Edukimit që do të përmirësojë treguesit cilësorë të zhvillimit të Programit të Edukimit në Vijimësi;
- ✓ Organizimi i veprimtarive me karakter profesional, promovime të figurave veterinarë;
- ✓ Pjesëmarrja dy herë në vit në Asamblenë e Përgjithshme të Federatës Veterinare Europiane (FVE) si dhe në Unionin European të Veterinerëve Praktik (UEVP), detyrime këto që burojnë nga qenia anëtar i Urdhrit Veterinar në këto organizata veterinarë europiane;
- ✓ Situata tejet e vështirë që nga fund-viti 2019 e në vijim, për shkak të pandemisë së Covid-it, ka krijuar pengesa dhe pamundësi serioze për organizimin, lëvizjen dhe grumbullimin dhe realizimin e aktiviteteve të planifikuara me mjekët veterinarë, të cilat kanë qenë edhe një burim i munguar të ardhurash për Urdhrin.

Shtesat dhe ndryshimet e propozuara në këtë projektligj, ku përfshihet dhe kërkesa për mbështetje buxhetore në formë transferte me një vlerë prej rreth 10 milion lekë, janë shumë të nevojshme për urdhrin, sepse ato do të mundësonin zgjidhjen e disa prej problemeve të ndeshura realisht dhe të parashtruara më lart, deri në formalizimin e Urdhrit, ku parësore janë evidentimi dhe përfundimi i anëtarësimit të të gjithë mjekëve zyrtarë, privatë, farmacistëve veterinarë, regjistrimi i teknikëve veterinarë e teknikëve të ndërzimit si dhe përfshirja në programin e edukimit dhe certifikimi profesional i tyre në nivel kombëtar, të cilët janë ende informalë në tregun e punës veterinarë.

Propozimi i uljes së numrit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar nga 21 në 15 anëtarë, të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, është i nevojshëm pasi përfaqësimi i zgjedhurve është më i lartë në raport me numrin e kufizuar të anëtarësisë si dhe një kosto për Urdhrin.

Numri i përfaqësimit nga institucionet të tjera me përfaqësim mbetet 4, por drejtuesi i shërbimit veterinar shtetëror (CVO) zëvendësohet me drejtuesit me drejtuesin e Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB), për shkak të përfaqësimit të lartë të anëtarësisë në këtë institucion.

Zgjatja e mandatit efektiv të Këshillit Kombëtar, Presidentit dhe Zëvendëspresidentit nga tre në pesë vjet është i nevojshëm edhe për shkak të vështirësive të ndeshura gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, të cilat kanë ndikuar negativisht në ushtrimin e veprimtarisë normale të institucionit gjatë mandatit të dytë dhe të reflektuara këto në pamundësi organizative dhe teknike. Zgjatja e mandatit nga tre në pesë vjet, do të bënte ekuivalentimin tij edhe me mandatet e urdhrave të tjerë homologe të vendit, siç janë Urdhri i Mjekut Human, Urdhri i Infermierit, Urdhri i Stomatologut, Urdhri i Farmacistit, Urdhri i Psikologut, të cilët janë me mandat mbi 3 vjeçar.

Ndërhyrja e parashikuar nëpërmjet politikave që propozohen mundëson që ndryshimet në ligjit nr. 113/2015 "Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar", të jenë një nevojë e domosdoshme që do ti shërbejë zgjidhjes së këtyre problemeve të hasura deri tani në terren.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

- ✓ Garantimi i vijueshmërisë dhe konsolidimi organizativ dhe ligjor i Urdhrit, nëpërmjet

mbështetjes buxhetore në formë transferte me një vlerë prej rreth 10 milion lekë për vitin 2022.

- ✓ Evidentimi dhe përfundimi i anëtarësimit të të gjithë mjekëve dhe farmacistëve veterinarë shtetërorë dhe privatë, regjistrimi i teknikë veterinarë e teknikëve të ndërzimit si dhe përfshirja në programin e edukimit dhe certifikimi profesionali tyre në nivel kombëtar brenda vitit 2025,
- ✓ Ngritja dhe funksionimi i Sistemit Kombëtar të edukimit profesional brenda vitit 2024.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e objektivave të politikës janë shqyrtuar opsionet e mëposhtme:

- ✓ Opsioni 0 (*status quo*): Nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo politikë të re: Ligji nr. 113/2015 "Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar", gjatë zbatimit ka paraqitur problemet e sipër cituar. Mos ndërhyrja dhe ruajtja e status quo-së, do të çojë në mos zgjidhjen e probleme të hasura dhe përkeqësim të situatës.
- ✓ Opsioni 1: Ndryshimi i ligjit ekzistues "Ligji nr. 113/2015 "Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar". Problemet e hasura gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, duhen adresuar me qëllim eliminimin e të gjitha të metave dhe mangësive të vërejtura. Opsioni i preferuar është ndryshimi i ligjit nr. 113/2015 "Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar", pasi problematikat e konstatuara zgjidhen në një kohë më të shkurtër dhe me një kosto më të ulët.
- ✓ Opsioni 2: Hartimi i një ligji të ri "Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar". Hartimi i një ligji të ri, do të sillte kosto më të lartë dhe zgjatjen e procedurave, për hartimin dhe miratimin e tij, si dhe do të prekte edhe çështje që nuk është e nevojshme të ndërhyhet në këtë moment.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet ekonomike të opsionit të preferuar do të përfshijnë kostot e drejtpërdrejta, të cilat do të shoqërohen me daljen e VKM përkatëse pas miratimit të politikës ku do të përcaktohet kostoja që buxheti i shtetit do të përballojë për mbështetje edhe një vit të Urdhrit.

Ndikim tjetër i drejtpërdrejtë i kësaj politike do të ketë edhe mbi grupet e interesit që kanë të bëjnë me Urdhërin e Mjekut Veterinar (gjithë veterinerët) sa i përket pagesave të kuotave të anëtarësisë. Do të ketë gjithashtu edhe disa lloje ndikimesh jo të drejtpërdrejta ekonomike, që janë pa vlerë monetare të drejtpërdrejta në buxhet dhe konsistojnë në rritjen e përgjegjësisë së subjekteve që zhvillojnë aktivitetin veterinar, si rezultat i trajnimeve dhe certifikimit forcohet kontrolli, si dhe ndikon në formalizimin e këtyre subjekteve.

Ndikimi mjedisor i drejtpërdrejtë. Identifikohen ndikime të drejtpërdrejta në mjedis nga zbatimi i kësaj politike, që sjellin impakt pozitiv në veterinarinë mjedisore ku përfshihen një sërë veprimtarish veterinarë në aspektin e bashkëpunimit dhe marrëdhënieve mjedis-kafshë-njerëz, si dhe në mbrojtjen e shëndetit publik veterinar.

Ndikimi Social i drejtpërdrejtë. Subjektet që zhvillojnë veprimtari në fushën e shëndetit të kafshëve, do të anëtarësohen të gjithë detyrimisht në Urdhrin, duke realizuar kështu formalizimin e tij.

Ndërkohë miratimi i këtyre ndryshimeve do të kontribuojë në vendosjen e karrierës profesionale në institucionet publike dhe private të mjekëve veterinarë, zbatimin e barazisë në tregun e punës veterinarë, si dhe uljen deri në reduktim të informalitetit në këtë fushë.

Ndikim *jo të drejtpërdrejtë* do të ketë edhe tek konsumatori për përdorim të produkteve veterinarë më të sigurt dhe cilësore, si pjesë e punës veterinarë, si dhe shkallë më të lartë gjurmueshmërie.

Rritja e sigurisë së produkteve ushqimore me origjinë shtazore do të ndikojë në rritjen e shkallës së besueshmërisë të konsumatori.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e optionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Analiza me shumë kritere e kryer për të tre optionet tregoi se optioni 1, ndryshimi i ligjit ekzistues “Ligji nr. 113/2015 "Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar", është vlerësuar me më shumë pikë dhe ne e kemi zgjedhur atë si optionin tonë të preferuar. Me optionin e përzgjedhur do të bëhet e mundur ruajtja e standardeve të larta në formimin, sjelljen profesionale dhe ushtrimin e profesionit të mjekut veterinar, duke garantuar mbrojtjen e shëndetit, mirëqenies së kafshëve dhe mbrojtjen e shëndetit publik, kryerja e aktiviteteve dhe veprimtarive profesionale shtesë dhe shumë të nevojshme.

Ky option përmbush më mirë pritshmëritë për ofrimin dhe garantimin e shërbimeve sa më cilësore nga mjekët veterinar dhe të barasvlefshme me standarde europiane, si profesion i rregulluar në Republikën e Shqipërisë,

Gjithashtu ndryshimi i ligjit ekzistues do të kontribuojë si një parakusht për zbatimin e karrierës në institucione publike ose private si dhe në realizimin e barazisë në tregun e punës veterinarë, përmes evidentimit, regjistrimit dhe pajisjes me certifikatë për ushtrimin e profesionit të mjekut veterinar.

Gjithashtu meqenëse ndryshimet e parashikuara në këtë politikë zënë më pak se 50% të neneve të Ligjit nr 113/2015 " Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar", shkojmë drejt optionit për disa shtesa dhe ndryshime.

Kostoja e përlogaritur në total e optionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare, menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë): të rishikohet dhe rivlerësohet!

Viti 1	Viti 2	Viti 3
10.000.000	0	0

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?) çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Për ndryshimet e Ligjit nr. 113/2015 “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar” janë kryer konsultime me grupe veterinerësh si dhe me anëtarët e Këshillit Kombëtar të Urdhrit, si organi

vendimmarrës, të cilët kanë shprehur dakortësinë e tyre për shtesat dhe ndryshimet e propozuara, dhe janë vlerësuar të nevojshme për forcimin organizativ të Urdhrit, në përmbushje të misionit ligjor të tij për ruajtjen e standardeve të larta në formimin, sjelljen profesionale të gjithë mjekëve dhe farmacistëve veterinarë si dhe të teknikëve veterinarë dhe teknikëve të ndërzimit dhe formalizimin e veprimtarisë së tyre veterinarë në institucionet shtetërore, publike dhe private.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 113/2015 “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar”, së bashku me relacion shpjegues dhe Raportin e Vlerësimit të Ndikimit (RIA) do të publikohet në Regjistrin Elektronik të Konsultimit Publik në website

<http://www.konsultimipublik.gov.al>.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi dhe monitorimi do të realizohen sipas përcaktimeve të dispozitave të projektligjit. Strukturat përgjegjëse që do të zbatojnë dhe monitorojnë ligjin janë organet drejtuese të Urdhrit:

- a) Asambleja e Përgjithshme;
- b) Këshilli Kombëtar;
- c) Komisioni Disiplinor;
- d) Komisionet e tjera sipas ligjit.

Asambleja e Përgjithshme, janë të gjithë anëtarët e Urdhrit, është përgjegjëse për zbatimin e ligjit, Kontrolli për zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij ushtrohet nga Këshilli Kombëtar, Komisioni Disiplinor dhe Komisionet e tjera të ngritura sipas ligjit.

- ✓ Këshilli Kombëtar është organi vendim-marrës dhe në përputhje me misionin e Urdhrit ushtron këto kompetenca të clat janë të përcaktuara në ligj dhe në Statutin e Urdhrit, të ndryshuar,
- ✓ Komisioni disiplinor ngrihet nga Këshilli Kombëtar për verifikimin dhe shqyrtimin e ankesave, në lidhje me shkeljet e Kodit të Etikës Profesionale të Mjekut Veterinar dhe shkeljet e tjera të kryera nga anëtarët e urdhrit. Veprimtaria e tij rregullohet me Statut dhe dhe me rregullores për kryerjen e veprimtarisë së tij .
- ✓ Komisionet e tjera sipas ligjit, ngrihen nga Këshilli Kombëtar dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas përcaktimeve ligjore, të cilat janë të përcaktuar më gjërësisht në Statutin e Urdhrit, të ndryshuar si dhe në Rregulloret e tyre përkatëse.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

✓ *Jepni kontekstin e politikës*

Urdhëri është miratuar me ligjin nr. 113/2015 “Për Urdhrin Profesional të Mjekut veterinar” dhe gjatë kësaj periudhe 6 vjeçare të zbatimit të tij, ky ligj nuk ka pësuar asnjëherë ndryshime.

Gjatë zbatimit të Ligjit nr. 113/2015 “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar”, janë kryer një sërë trajnimesh, të cilat kanë pasur efekte pozitive në rritjen e standardeve në veprimtarinë profesionale të mjekëve dhe teknikëve veterinarë, duke garantuar kështu cilësi më të larta shërbimi për mirëqenien dhe mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe mbrojtjen e shëndetit publik veterinar.

Por gjatë përmbushjes së misionit janë shfaqur edhe disa probleme ligjore, të cilat kanë penguar dhe vështirësuar mirëfunksionimin e Urdhrit dhe konkretisht: pamundësia financiare për përmbushjen e të gjitha detyrimeve ligjore për shkak të anëtarësisë së kufizuar, përfaqësimit më të lartë i të zgjedhurve në Këshillin Kombëtar të Urdhrit në raport me numrin e anëtarësisë, duke rritur koston për këtë Urdhër, pa qëndrueshmëria e strukturave të Urdhrit për shkak të periudhës 3 vjeçare të mandatit të tyre, të cilat kanë çuar në uljen e efektivitetit të punës së Urdhrit në lidhje me përmbushjen e misionit ligjor të tij.

Gjithashtu është i nevojshëm edhe unifikimi i ligjit Nr.113/2015 “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar” me Ligjin Nr. 123/2014, “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe me Ligjin Nr. 127/2014, "Për Urdhrit e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë", pasi profesioni i mjekut veterinar është profesion i rregulluar dhe në analogji me profesionin e mjekut human e stomatologut kanë ngjashmëri strukturore, prandaj është i nevojshëm edhe unifikimi i disa kërkesave sic është përshirja në ligj e të drejtave dhe detyrave për anëtarët e urdhrit, qartësimi i disa neneve, si dhe reduktimi i të zgjedhurve në raport me numrin e anëtarësisë etj.

Për sa më sipër rishikimi dhe përmirësimi i disa neneve të ligjit nr. 113/2015 "Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar", është një nevojë e domosdoshme që do ti shërbejë zgjidhjes së problemeve të ndeshura në praktikë.

Problemi në shqyrtim

- ✓ *Përshkruani natyrën e problemit.*
- ✓ *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- ✓ *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- ✓ *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem-qeveria/biznesi/shoqëria civile/qytetarët.*
- ✓ *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problemet e hasura gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, duhen adresuar me qëllim eliminimin e të gjitha të metave dhe mangësive të vërejtura. Opsioni i preferuar është ndryshimi i ligjit nr. 113/2015 "Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar", pasi problematikat e konstatuara zgjidhen në një kohë më të shkurtër dhe me një kosto më të ulët.

Arsyeja e ndërhyrjes

- ✓ *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- ✓ *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje*
- ✓ *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- ✓ *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- ✓ *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Zgjidhja e problematikave të identifikuar me qëllim eliminimin e të gjitha të metave dhe mangësive të vërejtura, kërkon këtë ndërhyrje si ligjiore, por edhe mbështetje financiare deri në konsolidim e mirëfunksionim të Urdhërit. Kjo ndërhyrje është e domosdoshme edhe referuar mbështetjes që Urdhërat e tjerë në rajon, kanë pasur të tilla problematika, por edhe mbështetjen e kanë përfituar në më shumë se një vit.

Ndërhyrja e nivelit të lartë është detyrim pasi Urdhëri, si pjesë e strukturave veterinare ka një rol kyç në përgatitjen profesionale të mjekëve veterinarë të domosdoshme, këto referuar standardeve të BE-së për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe shëndetit publik veterinar, sigurinë ushqimore.

Objektivi i politikës

- ✓ *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij*
- ✓ *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Politika e propozuar synon realizimin e objektivave si më poshtë:

- ✓ Garantimi i vijueshmërisë dhe konsolidimi organizativ dhe ligjor i Urdhrit, nëpërmjet mbështetjes buxhetore në formë transferte me një vlerë prej rreth 10 milion lekë për vitin 2022.
- ✓ Evidentimi i anëtarësimi i të gjithë mjekëve, farmacistëve veterinarë, regjistrimi i teknikëve veterinarë e teknikëve të ndërzimit si dhe përfshirja në programin e edukimit dhe certifikimi profesional i tyre në nivel kombëtar brenda vitit 2024.
- ✓ Ngritja dhe funksionimi i Sistemit Kombëtar të edukimit profesional brenda vitit 2024.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- ✓ *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- ✓ *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- ✓ *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Gjatë analizës së kryer, janë shqyrtuar të tre opsionet:

- ✓ Opsioni 0 (*status quo*): Nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo politikë të re: Ligji nr. 113/2015 "Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar", gjatë zbatimit ka paraqitur problemet e sipërcituar. Mos ndërhyrja dhe ruajtja e status quo-së, do të çojë në mos zgjidhjen e probleme të hasura dhe në përkeqësim të funksionimit të Urdhrit për shkak të disa rregullimeve ligjore të domosdoshme, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në formalizimin dhe konsolidimin organizativ dhe ligjor të tij.
- ✓ Opsioni 1: Ndryshimi i ligjit ekzistues "Ligji nr. 113/2015 "Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar"; Problemet e hasura gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, duhen adresuar me qëllim eliminimin e të gjitha të metave dhe mangësive të vërejtura. Opsioni i preferuar është ndryshimi i ligjit nr. 113/2015 "Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar", pasi problematikat e konstatuara zgjidhen në një kohë më të shkurtër dhe me një kosto të papërfillshme dhe ndërkohë kanë efekt të drejtpërdrejt në formalizimin dhe konsolidimin organizativ dhe ligjor të urdhrit veterinar.
- ✓ Opsioni 2: Hartimi i një ligji të ri "Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar". Hartimi i një ligji të ri për Urdhrin, do të sillte kosto më të lartë dhe zgjatjen e procedurave, për hartimin dhe miratimin e tij, si dhe do të prekte edhe çështje që nuk është e nevojshme të ndërhyhet në këtë për faktin se ligji ekzistues ka zgjidhur disa nga çështjet më kryesore dhe ka hedhur bazat që me ndryshimet e propozuara, Urdhri të formalizohet dhe konsolidohet për përmbushjen e objektivave ligjore.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- ✓ *Identifikoni se kush preket.*

- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- ✓ *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- ✓ *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Grupet që preken direkt janë;

Mjekët dhe farmacistët veterinarë, teknikët veterinarë, teknikët e ndërzimit.

Indirekt preket konsumatori, pasi rritja e performancës së trupave veterinarë ndikon në shëndetin e njeriut nëpërmjet ofrimit të shërbimit në kushtet e sigurisë ushqimore.

Ndikimet ekonomike

Ndikimi i drejtpërdrejtë i politikës është se ajo do të shoqërohet me daljen e VKM përkatëse pas miratimit të politikës ku do të përcaktohet kostoja që buxheti i shtetit do të përballojë për mbështetje edhe një vit të Urdhrit.

Ndikim tjetër i drejtpërdrejtë i kësaj politike do të ketë edhe mbi grupet e interesit që kanë të bëjnë me Urdhërin (gjithë veterinerët) sa i përket pagesave të kuotave të anëtarësisë.

Ndikimet mjedisore

Identifikohen ndikime të drejtpërdrejta në mjedis nga zbatimi i kësaj politike, që sjellin impakt pozitiv në veterinarinë mjedisore ku përfshihen një sërë veprimtarish veterinarë në aspektin e bashkëpunimit dhe marrëdhënieve mjedis-kafshë-njerëz, si dhe në mbrojtjen e shëndetit publik veterinar.

Ndikimet sociale:

Subjektet që zhvillojnë veprimtarinë në fushën e shëndetit të kafshëve, do të anëtarësohen të gjithë detyrimisht në Urdhërin dhe rrjedhimisht do të formalizohen. Miratimi i kësaj politike do të çojë në uljen deri në reduktim të informalitetit në këtë fushë.

Ndikimet ekonomike

Do të ketë gjithashtu edhe *disa lloje ndikimesh jo të drejtpërdrejta ekonomike*, që janë pavarësisht monetare të drejtpërdrejta në buxhet dhe konsistojnë në rritjen e përgjegjësisë së subjekteve që zhvillojnë aktivitetin veterinar, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe si rezultat i trajnimeve dhe çertifikimit, forcohet kontrolli, duke ndikuar në formalizimin e këtyre subjekteve.

Ndikimet sociale

Ndikim jo të drejtpërdrejta do të ketë tek konsumatori, për produkte veterinare më të sigurta dhe cilësore dhe shkallë më të lartë gjurmueshmërie.

Rritja e sigurisë së produkteve ushqimore me origjinë shtazore do të ndikojë në rritjen e shkallës së besueshmërisë te konsumatori.

- ***Vlerësimi i opsioneve:***

Nga vlerësimi i opsioneve nga grupi i punës, rezultoi se opsioni 1, ndryshimi i ligjit ekzistues “Ligji nr. 113/2015 “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar”, është vlerësuar me më shumë pikë dhe ne e kemi zgjedhur atë si opsionin tonë të preferuar. Me opsionin e përzgjedhur do të bëhet e mundur ruajtja e standardeve të larta në formimin, sjelljen profesionale dhe ushtrimin e profesionit të mjekut veterinar, duke garantuar mbrojtjen e shëndetit, mirëqenies së kafshëve dhe mbrojtjen e shëndetit publik, kryerja e aktiviteteve dhe veprimtarive profesionale shtesë dhe shumë të nevojshme. Ky opsion përmbush më mirë pritshmëritë për ofrimin dhe garantimin e shërbimeve sa më cilësore nga mjekët veterinar dhe të barasvlefshme me standarde europiane, si profesion i rregulluar në Republikën e Shqipërisë.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- ✓ Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- ✓ Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni 1: Ndryshimi i ligjit ekzistues “Ligji nr. 113/2015 “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar”;

Problemet e hasura gjatë zbatimit të ligjit ekzistues, duhen adresuar me qëllim eliminimin e të gjitha të metave dhe mangësive të vërejtura. Opsioni i preferuar është ndryshimi i ligjit nr. 113/2015 “Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar”, pasi problematikat e konstatuara zgjidhen në një kohë më të shkurtër dhe me një kosto të papërfillshme, pasi problematikat e konstatuara zgjidhen në një kohë më të shkurtër, janë me kosto të papërfillshme dhe ndërkohë kanë efekt të drejtpërdrejt në formalizimin dhe konsolidimin organizativ dhe ligjor të urdhrit veterinar.

1. Përcaktimi i kriterëve që tregojnë arritjen e objektivit për garantimin vijueshmërisë dhe konsolidimin organizativ dhe ligjor të Urdhrit:

- ✓ Efektiviteti në realizimin 100% të funksionimit të Urdhrit me ndërmarrjen e politikës që propozohet.
- ✓ Efektiviteti i punë së Urdhrit në çertifikimin e subjekteve veterinerë.
- ✓ Efektiviteti i anëtarimit në Urdhër të subjekteve veterinerë.

- ✓ Efektiviteti në shmangien e riskut organizativ të Urdhrit në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale të veterinerëve.
- ✓ Kosto efektiviteti.

1. Vendosja e peshës së kriterëve sipas rëndësisë relative

- ✓ Efektiviteti në realizimin 100% të funksionimit të Urdhrit me ndërmarrjen e politikës që propozohet: 5;
- ✓ Efektiviteti i punës së Urdhrit në çertifikimin e subjekteve veterinerë: 3.
- ✓ Efektiviteti i anëtarësimit në Urdhër të subjekteve veterinerë: 4.
- ✓ Efektiviteti në shmangien e riskut organizativ të Urdhrit në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale të veterinerëve: 5.
- ✓ Kosto efektiviteti: 5.

2. Përcaktimi i shkallës së performancës nëpërmjet intervalit të pikëve nga 0– 5

3. Vendosja e pikëve të opsioneve përkundrejt secilit kriter sipas matricës së mëposhtme.

Matrica e performancës

Kriteret	Pesha (Rëndësia relative)	Opsioni 0		Opsioni 1		Opsioni 2	
		Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)
Efektiviteti në realizimin 100% të funksionimit të Urdhrit me ndërmarrjen e politikës që propozohet	5	1	5	5	25	5	25
Efektiviteti i punës së Urdhrit në çertifikimin e subjekteve veterinerë	3	2	6	5	15	4	20
Efektiviteti i anëtarësimit në Urdhër të subjekteve veterinerë	4	0	0	5	20	4	16
Shkalla e organizativ të Urdhrit në funksion të ngritjes së kapaciteteve profesionale të veterinerëve	5	1	5	5	25	5	25
Kosto efektiviteti	4	0	0	5	20	2	8
Pikët totale për secilin opsion		16		105		94	

Analiza me shumë kriterë tregon se opsioni 1 (ndryshimi i ligjit ekzistues “Ligji nr. 113/2015 “Për Urdhërin Profesional të Mjekut Veterinar”) është vlerësuar me më shumë pikë dhe ne e kemi zgjedhur atë si opsionin tonë të preferuar.

Çështje të zbatimit

- ✓ Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- ✓ Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- ✓ Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës
- ✓ Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

Këshilli Kombëtar është organi vendim-marrës që në përputhje me misionin e Urdhrit menaxhon pasurinë/pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit, në nivel kombëtar dhe

administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme.

Komisioni i Planifikimit dhe Kontrollin Financiar dhe Ekonomik, i cili gjatë ushtrimit të detyrës kryen kontroll të plotë ose të pjesëshëm mbi zbatimin e planit ekonomik dhe financiar, sipas zërave dhe destinacionit të përdorur nga urdhri, në funksion të përmbushjes së misionit të përcaktuar me ligj.

Lidhur me opsionin e zgjedhur nuk parashikojmë risk i lartë për shkak të pengesave të mundshme për zbatimin e tij, pasi Urdhrit gjatë kryerjes së aktivitetit 6 vjeçar ka fituar pervojën e duhur organizative, ligjore dhe profesionale në administrimin e burimeve financiare si dhe ka krijuar infrastrukturën e nevojshme teknike dhe profesionale për ndjekjen dhe kontrollin e tyre. Gjithashtu mbështetja financiare nga Buxheti i Shtetit edhe për një vit, megjithë kostot, përbën instrument në uljen e riskut.

Për të arritur qëllimet e politikës do të ndërmerren masa të cilat përfshijnë;

- Vënien në mirëfunksionim të të gjitha strukturave të Urdhrit siç janë Komsionet e Perhershme pranë tij, me qëllim që ato mbështetur në Rregulloret e punës të përmbushin të gjitha objektivat sipas ligjit,
- Forcimi i llogaridhënies së strukturave të Urdhrit, si organe përgjegjëse para Këshillit Kombëtar, duke hatruar plan masash me afate e persona përgjegjës.

Kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit të opsionit të zgjedhur do të përshijnë kontrollin periodik të realizimit të objektivave të përcaktuar, përmes krijimit të dokumentacionit financiar dhe ekonomik si dhe informimi dhe transparanca me organet vendimarrëse të Urdhrit.

Gjatë zbatimit të projektligjit të propozuar, për të arritur qëllimet e politikës, do të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Plotësimi me aktin nënligjor të ligjit, që lidhet me miratimin e VKM-së për financimin e Urdhrit, edhe një vit nga Buxheti i Shtetit.
 - ✓ Përmirësimi i cilësisë së Edukimit Profesional, përmes krijimit të një Sistemi Kombëtar Edukimi, në kuadër të rritjes së pritshmërive të ofrimit dhe garantimit të shërbimeve sa më efektive nga mjekët veterinarë dhe me standarde të barasvlefshme me homologët europian, si profesion i rregulluar në Republikën e Shqipërisë,
 - ✓ Rritja e standardeve në veprimtarinë profesionale, si një kontribut dhe parakusht për zbatimin e karrierës në institucione publike ose private dhe realizimin e barazisë në tregun e punës veterinarë, përmes evidentimit, regjistrimit dhe pajisjes me certifikatë për ushtrimin e profesionit të mjekut veterinar.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- ✓ Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit
- ✓ Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.

Propozimi i këtij projektligji përmban elementë të rëndësishëm, për zbatimin e planit të punës, për sistemin e monitorimit dhe vlerësimit në zbatimin e ligjit, bazuar në problemet e konstatuara.

Indikatorët për të matur arritjen e objektivit janë si më poshtë:

- ✓ Deri në fund-vitin 2024 evidentimi dhe anëtarësimi në urdhër në nivel kombëtar i të mjekëve dhe farmacistëve veterinarë si dhe regjistrimi i teknikëve veterinar dhe teknikëve të ndërzimit
- ✓ Deri në fund-vitin 2023, ngritja e portalit të edukimit me mbështetje buxhetore, zgjerimi i bazës së trajnimeve dhe rritja e pjesëmarrjes të të gjithë mjekëve dhe teknikëve veterinarë,
- ✓ Formalizimi i të gjithë anëtarësisë së Urdhrit lidhur me zbatimin e kërkesave të ligjit për pjesëmarrjen në trajnime, paisjen me certifikatë për ushtrim profesional, sigurimi i krediteve të nevojshme për rinovimin e saj dhe përmbushja e detyrimeve financiare ndaj Urdhrit.
- ✓ Konsolidimi organizativ, përmes vendosjes së kordinatorëve në qarqe dhe vendosjes së astisistencës ligjore pranë Urdhrit.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN)-kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit) krahasuar me status quo-në.

Opsioni 1

Komponentet	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë	10,000,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë	700,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për biznesin – në vazhdim	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total	17,200,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës	17,200,000	6,193,428	5,901,311	5,622,975	5,357,762	5,105,061	4,864,282	4,634,858	4,416,250	4,207,957
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000
Përfitimi për grupet e tjera – një herë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										

Përfitimi në total	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000
Përfitimi i zbritur në total =Përfitimi në total x faktorin zbritës	5,500,000	5,240,593	4,993,417	4,757,902	4,533,491	4,319,667	4,115,931	3,921,803	3,736,827	3,560,579
Vlera aktuale e kostos në total	63,503,881									
Vlera aktuale e përfitimit në total	44,680,207									
Vlera aktuale neto (VAN) =Vlera aktuale e përfitimit në total - Vlera aktuale e kostos në total	- 18,823,674 lekë									

Opsioni 2

Komponentet	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë	11,300,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë	700,000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për biznesin – në vazhdim	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total	17,200,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000	6,500,000
Kosto e zbritur në total =Kosto në total x faktorin zbritës	17,200,000	6,193,428	5,901,311	5,622,975	5,357,762	5,105,061	4,864,282	4,634,858	4,416,250	4,207,957
Përfitimi për buxhetin –në vazhdim										
Përfitimi për biznesin –një herë										
Përfitimi për biznesin –në vazhdim	5.500.000	5.500.000	5.500.000	5.500.000	5.500.000	5.500.000	5.500.000	5.500.000	5.500.000	5.500.000
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000	5,500,000
Përfitimi i zbritur në total =Përfitimi në total x faktorin zbritës	5,500,000	5,240,593	4,993,417	4,757,902	4,533,491	4,319,667	4,115,931	3,921,803	3,736,827	3,560,579
Vlera aktuale e kostos në total	64,803,881									

Vlera aktuale e përfitimit në total	44,680,207
Vlera aktuale neto (VAN)= Vlera aktuale e përfitimit në total Vlera aktuale e kostos në total	- 20,123,674 lekë

Raporti i ndikimit të vlerësimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsiioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 0	0	0	0
Opsioni 1	64	45	-19
Opsioni 2	65	45	-20

Nga analiza e vlerësimit të ndikimit VAN, për opsionet 0, 1 dhe 2, rezultoi se opsioni 1 është i shoqëruar me kosto e përfitime, pra VAN më e vogël, krahasuar me opsionin 2, ndërsa opsioni 0, nuk mund të llogaritet nga ana jonë, pasi sikurse parashtruam tek analiza e opsioneve, niveli i status quo-s, do të sillte rrjedhoja negative për Urdhrin, deri në mosfunksionim.